



VENDIM

Nr. 102, Datë 18.08.2015

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E
RREGULLAVE TË ANKANDIT TË ZYRËS SË KOORDINUAR TË
ANKANDEVE PËR EVROPËN JUGLINDORE (SEE CAO) VERSIONI 1.2**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 65 pika 1 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike, nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.03.2009, i ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.08.2015, mbasi shqyrtoi draftin e përgatitur dhe të rënë dakort nga (SEE CAO) dhe TSO-të aksionerë të saj, të Rregullave të Ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandëve për Europën Juglindore (SEE CAO) dhe relacionin përkatës, për fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e Rregullave të Ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandëve për Europën Juglindore (SEE CAO),

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e rregullave të ankandit të zyrës së koordinuar të ankandëve për Europën Juglindore SEE CAO (bashkëlidhur draft **“Rregullat e Ankandit Versionin 1.2”** në gjuhën origjinale Angleze dhe të përkthyer në gjuhën Shqipe.
2. Në çdo rast mosmarrëveshjes, palët do t’i referohen versionit original të **“Rregullave të Ankandit Versionin 1.2”** në gjuhën angleze, për interpretim.
3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë personat e interesuar për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit AHMETI

